



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.07.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **28.06.2024** të parashtruar nga **Operatori Ekonomik "Cactus" Sh.a.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Shërbimet për Qytetin e Mençur "**, Nr. i prokurimit- **632-24-5736-2-1-1**, Nr. i brendshëm **632-24-073-211**, nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **"Cactus" Sh.a.**, e dt.28.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Shërbimet për Qytetin e Mençur "**, Nr. i prokurimit- **632-24-5736-2-1-1**, Nr. i brendshëm **632-24-073-211**, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë të AK –së, të datës 13.06.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË e publikuara me datë: **13.06.2024;**

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik **"Cactus" Sh.a.** me dt.28.06.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Shërbimet për Qytetin e Mençur "**, Nr. i prokurimit- **632-24-5736-2-1-1**, Nr. i brendshëm **632-24-073-211**.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.07.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj nuk qëndron, sepse ky aktivitet i prokurimit nuk mund të ndahet në lote, për arsye se të gjitha produktet ndërlidhen njëra me tjetrën dhe duhet të funksionojnë si një ekosistem dhe implementim që duhet të kryhet nga i njëjti OE, që të mos ketë ndonjë ngecje në ndërlidhjen e sistemeve

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit
